

Nr. 877 Prot.

Datë 10.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 849 Prot.

Sarandë, më 07.02.2025

Lënda: Shkresë përcjellëse për afishim.

Drejtuar:

BASHKISË DELVINË

Për dijëni:

**GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT
TIRANË**

Me anë të kësaj shkrese po ju përcjellim bashkëlidhur shkresën e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me Nr.12251, datë 04.02.2025, administruar pranë Bashkisë Sarandë me nr. 773 prot. datë 06.02.2025, për të kryer afishimin për efekt njoftimi të **shtetasit Aleksandër Gjikhima, banues në lagjen "Sinan Ballaci"** në kushtet ku bazuar në ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", adresa e cituar është pjesë e territorit të Bashkisë Delvinë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Irena MARJANI

Dr. Juridike
Shpallje
06.02.2025
Elmi



773
06.02.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 12251 (31114-00222-86-2018) Akti

Tiranë më 04.02.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, është regjistruar çështja administrative nr. 12251 (31114-00222-86-2018) regjistri themeltar, datë 17.01.2018 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS:

Kristo Naçi, i biri i Spiro-s, i datëlindjes 15.05.1969, lindur në Livadhja, Sarandë dhe banues në Kulluricë, Sarandë, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 2710 rep., nr.1229 kol., datë 17.10.2016, nga Avokat Ilir Nikolla, Avokat i Dhomës së Avokatisë Sarandë me nr.lic 3004 dhe Avokate Marsela Dura (Alia) Avokate e Dhomës së Avokatisë Sarandë me nr.lic 7492.

E PADITUR:

1. **Bashkia Sarandë.**
2. **Stivi Bani**, i biri i Ibrahim-it dhe i Feruze-s, i datëlindjes 02.11.1956, lindur dhe banues në Sarandë, lagjja nr. 1.
3. **Suzana Gjikhima**, banuese në Lukovë, Sarandë.
4. **Eva Gjikhima**, banuese në Lukovë, Sarandë.
5. **Blerta Gjikhima**, banuese në Lukovë, Sarandë.
6. **Besana Gjikhima**, banuese në Lukovë, Sarandë.

7. **Aleksandër Gjikhima**, i biri i Spiro-s dhe i Luizës, i datëlindjes 18.01.1973, lindur dhe banues në Delvinë, në adresën: lagjja "Sinan Ballaci"

8. **Këshilli i Qarkut Vlorë.**

9. **Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.**

10. **Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike Tiranë.**

OBJEKTI:

1. Rivendosi e së drejtës së shkelur

2. Deklarimi absolutisht të pavlefshëm të:

- Kontratë shitblerje nr.1874 rep, 403 kol, datë 24.12.1997 midis palëve, Këshilli i Rrethit Sarandë e Stivi Bani dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

- Kontratë shitblerje nr.3 rep, -1 kol, datë 05.01.1998 midis palëve të paditura Stivi Bani dhe Andrea Gjikhima e Aleksandër Gjikhima dhe fshirje nga regjistri hipotekor.

- Detyrimin e palës së paditur të njohë pronar paditësin, të lirojë dhe të dorëzojë pronën e paditësit, truall i ndodhur në Lagja Nr.1, Zona "Mbi Regjiment", Sarandë, parcela Nr.B- 34 me sip 300 m2 me kufizime: Nga veriu me rrugë, Jugu me rrugë, Lindja me parcelën B-34/1 dhe Perëndimi me parcelën B-33/1. E zënë në kundërshtim me ligjin".

BAZA LIGJORE:

Neni 31, 32/a, 153, 154, 253, 254 e vijues i Kodit të Procedurës Civile;

Neni 83, 92/a, b, 149, 162, 163-165, 192, 193, 195, 296 e vijues, 584 i Kodit Civil;

Neni 116, 117 i Kodit të Procedurës Administrative;

Neni 3 i Ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995, "Për shitblerjen e trojeve";

Neni 24/a i Ligjit nr. 7843, datë 13/07/1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (i ndryshuar);

Ligji nr. 33/2012, datë 21/03/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme";

Ligji nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative".

Bazuar në nenin 133 të K.Pr.Civile, njoftohen me anë të kësaj shpallje palëve të paditura në këtë gjykim:

Stivi Bani (*banues në Sarandë, lagjja nr. 1*)

Suzana Gjikhima (*banuese në Lukovë, Sarandë*)

Eva Gjikhima (*banuese në Lukovë, Sarandë*)

Blerta Gjikhima (*banuese në Lukovë, Sarandë*)

Besana Gjikhima (*banuese në Lukovë, Sarandë*)

Aleksandër Gjikhima (*banues në lagjja "Sinan Ballaci", Delvinë*)

Se, me datë 27.02.2025, ora 10:40 në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë do të zhvillohet dhoma e këshillimit për gjykimin e çështjes me palë dhe objekt si më sipërcituar, duke ju bërë me dije që si rezultat i ndryshimeve ligjore të miratuara me ligjin nr. 111/2018 "Për kadastrën", si dhe referuar përcaktimeve të nenit 199 të K.Pr.Civile, ka vendosur të bëjë kalimin procedural në këtë gjykim të palëve të paditura Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë në Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Drejtoria Vendore Sarandë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike Tiranë tek Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike.

Kopje të kësaj shpallje publike të vendosen në Bashkinë Sarandë, në ambientet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje (Zyra e Shërbimit Gjirokastër), në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në faqen e Web www.gjykata.gov.al, si dhe një kopje të depozitohet në dosjen gjyqësore.

Bashkëngjitur dhe nga një kopje të shkresës për komunikimin e kalimit procedural për paditësin e sipërcituar.

G J Y Q T A R
Gentian HAMITI

